



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PEJËS PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Pejës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Pejës (KP), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Pejës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Komuna gjatë ekzekutimit të buxhetit kishte realizuar pagesa në vlerë 555,020€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate;
- B2 Pasuritë e komunes ishin të mbivlerësuar për 4,351,051€ si rezultat i regjistrimeve të gabuara dhe mos bartjes së pasurive; dhe
- A1 Obligimet e papaguara janë mbivlerësuar për 30,610€ si rezultat i mos mbajtjes së evidencave të plota dhe të sakta.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Pejës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A2 Komuna nuk kishte arritur të realizojë nivelin e kërkuar të verifikimeve të pronave sipas kërkesave ligjore;
- A3 Komuna nuk ka regjistruar pagesat nga palët e treta në SIMFK;
- A4 Moskonfiskimi i sigurisë së ekzekutimit pas ndërprerjes së kontratës;
- B3 Në tetë (8) raste përfituesit e subvencioneve nuk kishin dorëzuar raporte për arsyetimin/shpenzimin e mjeteve të përfituara;
- B4 Në shtatë (7) raste vonesat në pagesën e faturave ishin nga 25 deri në 250 ditë;
- B5 Menaxhimi i kontratave nuk është administruar përmes platformës së prokurimit elektronik (E-prokurimi); dhe
- C1 Në dy (2) raste, kemi evidentuar vonesa në realizimin e projekteve edhe përtej afatit që ishte përcaktuar me amandamentim të kontratave.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Pejës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Pejës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Pejës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Pejës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Pejës.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat me probleme më të theksuara të cilat kanë ndikuar në opinionin e auditimit kishin të bënin me klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve, mbivlerësimin e pasurive në regjistra kontabël dhe mbivlerësimin e obligimeve të papaguara.

Ndërsa, sa i përket mospajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, komuna duhet t'i forcoj edhe më tej kontrollet pasi ishin identifikuar mangësi si: niveli i ulët i inspektimeve të pronave, mosregjistrimi i pagesave nga palët e treta në SIMFK, moskonfiskimi i sigurisë së ekzekutimit pas ndërprerjes së kontratës, vonesa në pagesën e faturave dhe në realizimin e projekteve kapitale, dobësi në menaxhimin e subvencioneve dhe rritje të llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë.

Po ashtu, menaxhimi i kontratave nuk po zbatohet përmes platformës së e-prokurimit dhe rregullorja për klasifikimin e vendeve të punës ende nuk ishte finalizuar.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 12 rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja, shtatë (7) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Ligji mbi Ndarjet Buxhetore Nr. 08/L-332 në nenin 15 paragrafi 12 përcakton se, ndarjet buxhetore nga "Rezerva" me prioritet ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për shlyerjen e vendimeve përmbarimore dhe gjyqësore me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ.

Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parasë publike" shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Ne identifikuam klasifikim jo adekuate të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë prej 555,020€, si në vijim:

- Me vendim të gjykatës për zbatimin e kontratës kolektive nga kategoria e investimeve kapitale janë paguar 215,479€, kurse nga kategoria mallra dhe shërbime 60,118€; dhe
- Me vendim të gjykatës shpronësimet janë paguar nga investimet kapitale në vlerë prej 1,098,688€ e ku rezulton se vlera prej 279,423€ do të duhej paguar nga kategoria mallra dhe shërbime, pasi kishin të bënin me shpenzime të përmbarimit, interesit dhe tjera.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk kishte marrë parasysh kërkesat e ligjit të buxhetit për të bërë planifikim adekuat sipas nevojave dhe kërkesave të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse.

Ndikimi

Pagesat e realizuara nga kategoria jo-adekuate, shpien në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare Vjetore të komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e PFV-ve.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë që, me rastin e përgatitjes së buxhetit të merr parasysh kërkesat e ligjit të buxhetit dhe qarkores buxhetore të MFPT, në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Dobësi në regjistrin kontabël të pasurive

Gjetja

Sipas nenit 6 të Rregullores Nr. 02/2013 “Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore”, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”. Po ashtu sipas nenit 11 thuhet se pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësisë të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi.

Nga testimet dhe analizat e regjistrit të pasurive identifikuam se pasuritë e komunes ishin të mbivlerësuara për 4,351,051€, si në vijim:

- Dy pagesa në vlerë totale prej 53,138€ ishin regjistruar gabimisht në vlerë prej 5,313,978€, si pasojë e një gabimi teknik nga zyrtari i pasurisë, duke shkaktuar mbivlerësim të pasurisë në PFV për 5,260,840€. Pas identifikimit të regjistrimit të gabuar gjatë vitit 2026 janë ndërmarrë veprime për korrigjimin e këtij gabimi;
- Projekti “Asfaltimi i rrugës Shtupeq i Madh - Rugovë në Komunën e Pejës”, me vlerë prej 1,254,881€, i financuar nga Ministria e Infrastruktues dhe pranuar teknikisht në vitin 2020 nga Komuna, nuk ishte bartur në regjistrat e pasurisë, dhe për rrjedhojë kishte shkaktuar një nënvlerësim të pasurisë së Komunës për 909,789€ (vlera neto pas zhvlerësimit). Kjo pasuri ishte duke u mbajtur ende në regjistrat e Ministrisë si investim në vijim; dhe

- Kontrata “Ndërtimi i palestrës në Zahaq” në vlerë 855,855€ është pranuar teknikisht në muajin dhjetor 2025, mirëpo në regjistrat e pasurisë në SIMFK ka mbetur e regjistruar si investim në vijim dhe nuk është bartur në kategorinë e pasurive në përdorim.

Mangësitë e identifikuar kishin ardhur si rezultat i kujdesit jo të duhur dhe mos-funksionimit të kontrolleve të brendshme në procesin e menaxhimit të pasurive kapitale dhe jo kapitale.

Ndikimi Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që ka në dispozicion komuna. Si rrjedhojë e këtyre mangësive kemi mbivlerësim të pasurive duke rezultuar edhe në prezantimin jo të drejtë të vlerës së tyre në pasqyra financiare.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave dhe zyrtarit të pasurive se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar saktë në regjistrat kontabël. Po ashtu, duhet shtuar kujdesin që të kërkohet në kohën e duhur bartja e pasurive të Komuna si pronare e tyre për pasuritë që janë financuar nga Ministritë dhe është bërë pranimi teknik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Mbivlerësim i obligimeve në PFV

Gjetja Sipas nenit 17.3 të Rregullores MF nr.01/2017 për Raportim Financiar Vjetor, "Organizatrat Buxhetore duhet t'i raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) për vitin raportues".

Në pasqyrat financiare janë prezantuar obligime në vlerë prej 30,610€, të cilat i përkasin viteve të mëhershme dhe për të cilat nuk na janë ofruar dëshmi. Gjatë auditimit, nga zyrtarët e komunës është kërkuar konfirmimi i këtyre obligimeve me operatorin ekonomik, me ç'rast operatori përmes emailit ka deklaruar se komuna nuk ka asnjë obligim ndaj tyre.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së koordinimit dhe komunikimit me kohë ndërmjet zyrtarëve përgjegjës, si dhe mungesës së procedurave adekuate të verifikimit të obligimeve para përfshirjes së tyre në PFV.

Ndikimi Prezantimi i obligimeve që nuk ekzistojnë ka ndikuar në mbivlerësimin e tyre dhe rrjedhimisht edhe në prezantimin jo të saktë të tyre në PFV.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave një kordinim më efektiv në mes drejtorive në raportimin e faturave të papaguara me qëllim që në PFV të shpaloset vlera e saktë e obligimeve të papaguara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Mosrealizimi i inspektimit të pronave sipas kërkesave ligjore

Gjetja Sipas nenit 15 të Ligji nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, "Veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën njëzet përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës dhe vetëm kur është e nevojshme për parcela.

Komuna nuk kishte arritur të realizojë nivelin e kërkuar të inspektimeve të pronave sipas kërkesave ligjore. Nga gjithsej 45,114 prona të regjistruara, gjatë vitit 2025 ishin inspektuar vetëm 1,325 prona ose rreth 3% e tyre.

Kjo kishte ndodhur për shkak të fokusimit të ulët të aktiviteteve për verifikim dhe vështirësive teknike në funksionimin e programit të ri të tatimit në pronë.

Ndikimi Mosrealizimi i verifikimeve në nivelin e kërkuar rrit rrezikun që të dhënat për pronat të mos jenë të plota dhe të sakta, duke ndikuar në identifikimin e ndryshimeve në prona dhe rrjedhimisht edhe në llogaritjen dhe inkasimin e drejtë të tatimit në pronë.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktiviteteve për verifikimin e pronave të paluajtshme, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale në prona të integrohen në bazën e të dhënave dhe të reflektojnë detyrimin e saktë tatimor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mos regjistrim i pagesave nga palët e treta në SIMFK

Gjetja Sipas nenit 9.6 të Rregullorës 01/2017 për Pasqyrat Financiare Vjetore të Organizatave Buxhetore "Të gjitha pagesat nga palët e treta duhet të regjistrohen në SIMFK në harmoni me procedurën përkatëse dhe të prezantohen në pasqyrat financiare".

Komuna nuk ka regjistruar pagesat nga palët e treta në SIMFK në vlerë 20,000€ e cila ishte prezantuar te shënimi 13 Pagesa nga palët e treta në PFV.

Shkaku i mosregjistrimit të pagesave nga palët e treta në SIMFK lidhet me mungesën e kontrolleve të brendshme efektive.

Ndikimi Mos regjistrimi i pagesave nga palët e treta në SIMFK ka ndikuar që Ministria e Financave të mos ketë njohuri për këto pagesa, me ç'rast RVF e Buxhetit të Republikës së Kosovës është nënvlerësuar për këtë shumë.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave që pagesat nga palët e treta të regjistrohen në SIMFK.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A4 - Moskonfiskimi i sigurisë së ekzekutimit pas ndërprerjes së kontratës**

Gjetja Sipas nenit 29.1 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, siguria e ekzekutimit është paraparë si mekanizëm për të garantuar përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga kontrata. Ndërsa, neni 29.8 përcakton se autoriteti kontraktues duhet të konfiskojë sigurinë e ekzekutimit në rastet kur operatori ekonomik shkel kontratën e nënshkruar dhe si pasojë i shkaktohen dëme materiale autoritetit kontraktues dhe/ose krijohen shpenzime të konsiderueshme për përfundimin e kontratës.

Kontrata “Ndërtimi i sallës së sporteve në fshatin Glllogjan”, e nënshkruar me datë 16.02.2024 në vlerë prej 300,000€, është ndërprerë sipas vendimit nga kryetari i komunës me datë 09.08.2025, për shkak të dështimit të operatorit ekonomik në përmbushjen e obligimeve kontraktuale. Bazuar nga sitacionet dhe pagesat e kryera kontrata ishte përmbushur në vlerë prej 101,962€ apo 34% e saj. Nga vendimi për ndërprerjen e kontratës vërehet se OE ka refuzuar të përmbushë kushtet e specifikuar në kontratë përkundër vërejtjeve të vazhdueshme nga menaxheri i kontratës. Përkundër dëmeve në përmbushjen e kontratës, Komuna nuk kishte ndërmarrë veprime për konfiskimin e sigurisë së ekzekutimit, siç parashihet me rregulloren e prokurimit publik.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së veprimeve nga zyrtarët përgjegjës për menaxhimin dhe monitorimin e kontratës dhe departamentit të prokurimit lidhur me konfiskimin e sigurisë së ekzekutimit.

Ndikimi Moskonfiskimi i sigurisë së ekzekutimit ka rezultuar në moskompensim të dëmeve që i shkaktohen komunës dhe dobëson mekanizmat e aplikimit të masava të parapara me ligj ndaj operatorëve ekonomikë që nuk i përmbushin obligimet kontraktuale.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë që në rastet e mos përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga operatorët ekonomikë, zyrtarët përgjegjës të ndërmarrin me kohë të gjitha veprimet e parapara me legjislacionin e prokurimit publik, përfshirë edhe konfiskimin e sigurisë së ekzekutimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B3 - Dobësi në menaxhimin e subvencioneve**

Gjetja Sipas nenit 23 të Rregullores Komunale 01/2017 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, përfituesit e subvencioneve të ndara nga Komuna obligohen që Komunës ti dorëzojnë raport financiar dhe përshkruar. Raporti duhet t'i ketë të gjitha shpenzimet e dokumentuara (raportin bankar, fatura të rregullta).

Në tre (3) raste të testuara për ndarjen e subvencioneve për OJQ në vlerë 24,000€ dhe në pesë (5) raste të subvencioneve për përfitues individualë në vlerë 16,500€, identifikua se mungojnë raportet e detajuara (përfshirë faturat, transaksionet dhe dëshmitë tjera) mbi përdorimin e mjeteve të përfituara siç parashihet edhe në marrëveshjet e subvencionimeve.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mosdefinimit të zyrtarëve përgjegjës për

monitorimin dhe përmbushjen e kërkesave sipas marrëveshjes për subvencionimin e përfituesve.

- Ndikimi** Mos dorëzimi i raporteve narrative dhe financiare për periudhat raportuese, pamundëson monitorimin dhe verifikimin e përdorimit të subvencioneve sipas qëllimit të aprovuar.
- Rekomandimi B3** Kryetari duhet të kërkoj përmes drejtorive përkatëse monitorimin dhe sigurimin e raporteve financiare dhe narrative nga përfituesit në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Vonesa në pagesën e faturave

- Gjetja** Sipas nenit 39 të LMFPP-së Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit përcaktohet se ZKF i Organizatës Buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për OB-në të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim.

Në shtatë (7) raste, faturat në vlerë prej 381,757€ ishin paguar me vonesë nga 25 deri në 250 ditë ku prej tyre në një (1) rast fatura në vlerë prej 98,050€ nuk ishte paguar brenda afatit 30 ditor dhe, si rrjedhojë, çështja ishte proceduar për përmbarrim pas 42 ditësh, duke shkaktuar kosto shtesë në vlerë prej 729€.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontroleve jo adekuate në ekzekutimin e pagesave dhe përdorimit të fondeve për pagesa me vendime gjyqësore.

- Ndikimi** Si pasojë e vonesave në pagesën e faturave, komuna mund të përballlet me kosto shtesë të interesave e gjobave për vonesat e shkaktuara të kërkuara nga palët e treta.
- Rekomandimi B4** Kryetari duhet të sigurojë që obligimet financiare kryhen brenda afatit prej 30 ditëve, (përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për mundësinë e ridestinit të mjeteve) për të shmangur kostot shtesë si pasojë e vonesave në pagesën e faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit

- Gjetja** Sipas Rregullores nr. 001/2022 të KRPP, konkretisht nenit 70.1 dhe paragrafit 70.24.f, administrimi i kontratave duhet të realizohet përmes platformës së prokurimit elektronik (E-prokurimi). Ky paragraf përcakton se Menaxheri i Kontratës është i obliguar të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mirëmbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhimin e kontratës në sistemin e prokurimit elektronik.

Në nëntë (9) rastet e testuara kemi vërejtur se menaxhimi i kontratave nuk është administruar përmes platformës së prokurimit elektronik (E-prokurimi).

Prioriteti i ulët që i është dhënë menaxhimit të kontratave përmes platformës së e-prokurimit nga menaxhmenti dhe mungesa e trajnimeve për menaxherët e kontratave ishin shkaqet kryesore të kësaj mangësie.

Ndikimi

Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në një menaxhim jo efektiv të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë nga të gjithë menaxherët kontratave që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik. Po ashtu, duhet organizuar trajnime për menaxherët e kontratave dhe monitorim të përdorimit të tij.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Vonesa në realizimin e projekteve kapitale

Gjetja

Sipas nenit 70.23 të Rregullave Nr. 001-2022 për prokurimin publik, menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Në kontratat e lidhura ndërmjet komunës dhe operatorëve ekonomik, janë përcaktuar afatet kohore të realizimit të kontratave

Në dy (2) raste, kemi evidentuar vonesa në realizimin e projekteve edhe përtej afatit të amandamentimit të kontratave, si në vijim:

- Kontrata "Ndërtimi i palestrës në Zahaq" ishte amandamentuar dhe data e përfundimit të kontratës ishte 08.07.2025, përderisa punimet kanë përfunduar në muajin dhjetor 2025 me një vonesë mbi pesë (5) muaj; dhe
- Kontrata "Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat Nabergjan, Trestenik, Lutogllave, Ruhot dhe Llabjan" ishte amandamentuar dhe data e përfundimit të kontratës ishte 20.08.2025 perderisa punimet kanë përfunduar në muajin tetor 2025 me një vonesë prej dy (2) muajve

Shkak i vonesave ishte mungesa e fondeve në dispozicion për të përfunduar kontratën sipas planit dinamik, fondet e projekteve të caktuara ishin shfrytëzuar për pagesën e obligimeve të daluara nga kontrata kolektive, si dhe mos funksionimi i duhur i kontrolleve për ti mbajtur përgjegjës operatorët ekonomike në kryerjen e punimeve sipas afatit të përcaktuar me kontratë.

Ndikimi

Vonesat në kryerjen e projekteve ndikojnë në rritjen e obligimeve kontraktuese të cilat mund të kenë implikime buxhetore për buxhetin e vitit pasues. Kjo, po ashtu, ndikon në performancën dhe mos arritjen e objektivave të përcaktuara të Komunës.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë me një mbikëqyrje rigoroze në menaxhimin e kontratave. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje është 20,191,900€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 2,208 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 2,181.

Çështja B6 - Mos finalizimi i rregullores për klasifikimin e vendeve të punës

Gjetja

Sipas nenit 34 i Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil, Obligohen institucionet në fushën e veprimt të kësaj Rregulloreje të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.

Komuna ende nuk e kishte finalizuar Rregulloren për klasifikimin e vendeve të punës dhe vënien e saj në zbatim.

Kjo vjen si shkak i planifikimeve për shtimin dhe fuzionimin e drejtorive duke i pershtatur këto ndryshime edhe në statut.

Ndikimi

Si rezultat i mungesës së aprovimit të Rregullores nuk arrihet qëllimi që të krijojë një sistem i njëtrajtshëm i pagave në Komunë që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës si dhe krijimin i një sistemi të pagave dhe shpërblimeve.

Rekomandimi B6

Kryetari duhet të sigurojë që në afatin më të shkurtër janë ndërmarre veprime për dërgimin e rregullores për aprovim në Kuvendin Komunal.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Të arkëtueshmet

Komuna në vitin 2025 ka shpalosur në PFV llogaritë e arkëtueshme në vlerë 20,401,779€. Kjo vlerë përbehet nga llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë në vlerë 20,224,723€, taksat nga qiraja në vlerë 140,756€, të tjera në vlerë 36,300€.

Çështja B7 - Rritja e llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë.

Gjetja Sipas nenit 30 të Ligjit Nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, për detyrimet tatimore të papaguara, Komuna është e obliguar të nxjerrë vendim për ekzekutimin e tyre dhe t'i propozojë për përmbarim organit kompetent përmbarues.

Në krahasim me vitin paraprak, ka rritje të llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë nga 18,144,048€ në 20,224,724€ që paraqet një rritje prej 2,080,676 € ose rreth 12%. Komuna nuk ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për inkasimin e detyrimeve të papaguara, përfshirë iniciimin e procedurave përmbarimore për borxhet e maturuara.

Rritja e llogarive të arkëtueshme është si rrjedhojë e mungesës së veprimeve të mjaftueshme në drejtim të inkasimit të llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi Mos realizimi i të hyrave të planifikuara, rritë rrezikun e dështimit të projekteve të planifikuara nga burimet vetanake. Vjetërsia e të arkëtueshmeve e vështirëson apo edhe pamundëson mbledhjen e tyre.

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e të arkëtueshmeve, si dhe rritjen e efikasitetit për arkëtimin e tyre. Poashtu të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve si dhe të krijojë strategji të mbledhjes së tyre, përfshirë dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme ligjore për inkasim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjate auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Këto ishin si më poshtë:

Çështjet materiale të cilat ne i kemi identifikuar dhe janë përmirësuar gjatë kohës së auditimit

Çështja 1 **Mangësi në draft pasqyrat financiare dhe shënimet shpjeguese**

Gjetja

Ne rishikuar PFV-të 2025 të Komunës së Pejës dhe kemi vërejtur diferenca në mes shifrave të prezantuara në PFV e Komunës dhe Shënimeve të Thesarit. Diferencat që ne identifikuar kanë të bëjnë me pikat si në vijim:

- Neni 14, Hyrja e parasë se gatshme, tek shënimi 11 Grantet e përcaktuara te donatoreve kolona buxheti final duhet te prezantohet ne vlere te njëjtë me realizimin 239.
- Neni 14.6 Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit tek hyrjet, duhet te bëhen korigjime te granatet e përcaktuara te donatoreve;
- Shenimi 13 Pagesa nga palët e treta, vlerat. Sipas shabllonit të shënimeve në pasqyrat financiare, të vlera duhet të paraqiten në mijëra ('000). Në shënimin përkatës, shpenzimi është paraqitur në shumën 20,000, ndërsa duhet te paraqitet si 20 per vitin 2025 dhe 27 për vitin 2024. Ndërsa në vitin 2023 vlera duhet te jetë 0 (bazuar ne PFV e vitit te kaluar)

Veprimi i kërkuar

Menaxhmentit të entitetit i është kërkuar që të ndërmarrë veprime për t'i korigjuar Pasqyrat Financiare Vjetore.

Rezultati

Menaxhmenti ka bërë korigjimet për çështjet që i kemi sugjeruar. Këto gabime kanë rezultuar për shkak të kontrolleve të brendshme jo të mjaftueshme, prandaj ne ju tërheqim vëmendjen se nëse këto gabime përsëriten në PVF e vitit vijues atëherë çështja do të rezultojë me rekomandim në raportin e auditimit.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Burimet e fondeve	39,842,382	43,102,061	40,924,714	42,469,616	40,240,828
Grante Qeveritare - Buxheti	34,248,872	35,616,125	35,319,271	34,850,160	32,105,989
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,420,328	1,058,646	1,406,774	3,204,030
Të hyrat vetanake	5,593,510	5,593,510	4,283,640	5,082,091	4,638,510
Donacionet vendore	0	99,500	74,028	40,409	73,212
Donacionet e jashtme	0	372,599	189,128	1,090,182	219,087

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 3,259,680€. Kjo rritje ishte nga granditë e Qeverisë prej 1,367,253€, nga bartja e të hyrave vetjake nga viti paraprak prej 1,420,328€, si dhe prej donacioneve 472,099€.

Në vitin 2025 komuna ka shpenzuar 95% të buxhetit final ose 40,924,714€, me një ulje 3% në krahasim me vitin 2024. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Shpenzimet	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	39,842,382	43,102,061	40,924,714	42,469,616	40,240,828
Pagat dhe mëditjet	18,808,949	20,191,900	20,135,425	21,108,803	19,291,105
Mallrat dhe shërbimet	5,297,000	5,527,144	5,319,371	5,395,811	4,488,837
Komunalitë	1,054,775	1,054,775	1,040,734	967,275	909,564
Subvencionet dhe transferet	1,200,000	1,288,395	1,258,326	1,115,880	958,326
Investimet Kapitale	13,481,658	15,039,848	13,170,857	13,881,847	14,592,995

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,382,951€. Ky ndryshim ishte rezultat i vendimit të Qeverisë për ndarje buxhetore në vlerë 1,367,253€ (për rritje të koeficientit të pagave) dhe nga donacionet 15,698€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte pothuajse 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 230,144€. Rritja vjen nga bartja e të hyrave vetjake nga viti paraprak prej 41,207€ dhe nga donacionet prej 188,937€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 96%;
- Buxheti final për shpenzime komunale ishte i njëjtë me buxhetin fillestar. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte rreth 99%;
- Buxheti final për subvencione në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 88,395€. Rritja vjen nga bartja e të hyrave vetjake nga viti paraprak prej 9,850€ dhe nga donacionet prej 78,545€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte rreth 98%; dhe
- Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,558,190€. Rritja vjen nga bartja e të hyrave vetjake nga viti paraprak prej 1,369,271€ dhe nga donacionet 188,919€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte rreth 88%. Shpenzimi nga kjo kategori ndër tjerash kanë të bëjë me pagesat e bëra për projektet kapitale si për ndërtimin e rrugëve lokale, rregullimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtimin e objekteve, fushave sportive.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2025 ishin 5,593,510€, përderisa ishin realizuar 6,564,635€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, lejet mjedisore, taksat administrative, participimet, të hyrat nga qiraja etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2025 Pranimet	2024 Pranimet	2023 Pranimet
Totali i të hyrave	5,593,510	5,593,510	6,564,635	5,192,419	5,326,833
Të hyrat tatimore	2,972,177	2,972,177	2,218,775	2,208,683	2,761,006
Të hyrat jo tatimore	2,621,333	2,621,333	4,343,335	2,983,736	2,565,827
Të hyrat tjera	0	0	2,525		

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 ka rezultuar me 14 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar, shtatë (7) rekomandime nuk janë zbatuar, dhe një (1) rekomandim është pjesërisht i zbatuar siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PVF.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e mbështetjes financiare ndaj OJQ-ve të emërohen zyrtarët përgjegjës për monitorimin e implementimit të projekteve, dhe OJQ-të përfituese të dorëzojnë raporte financiare dhe narrative në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurohet se funksionon kontrolli i duhur përmes zyrës së prokurimit, ashtu që, të rishikoj se njësitë kërkuese bëjnë hartimin e projektit ekzekutiv sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.	Nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet puna/shërbimi dhe të kryhet pagesa.	Nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të forcojë kontrollet gjatë vlerësimit të projekteve, duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit për çdo projekt kapital të ketë buxhet të aprovuar dhe fonde të mjaftueshme për realizimin e projekteve.	Nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
6.	Baza për konkluzion	Kryetari të sigurojë se kontrollet e vendosura janë funksionale, sa i përket pronave të dhëna me qira, të kërkoj nga departamentet përgjegjëse një monitorim të rregullt për tu informuar së janë duke u përmbushur kushtet e kontratave nga qiramarrësit.	Është implementuar rekomandimi.	I zbatuar
7.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë me një mbikëqyrje rigoroze në menaxhimin e kontratave. Realizimi i pagesave të bëhet në përputhje me afatet kohore të kontratës.	Nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
8.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që obligimet financiare të kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
9.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se raportet rregullta gjashtë (6) mujore të përmbajnë edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.	Nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
10.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë që në afatin më të shkurtër janë ndërmarrë veprime për dërgimin e rregullores për aprovim në Kuvendin Komunal.	Nuk është finalizuar rregullorja.	Nuk ka filluar zbatimin
11.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë nga të gjithë menaxherët kontratave që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin

12.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontroleve në këtë fushë me një mbikëqyrje rigoroze në menaxhimin e kontratave. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve.	Pavarsisht përmirësimeve nga viti i kaluar edhe këtë vit ka raste të tilla.	Pjesërisht i zbatuar
13.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar saktë në regjistrat kontabël dhe në kategori përkatëse, sipas kërkesave ligjore.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
14.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e të arkëtueshmeve, si dhe rritjen e efikasitetit për arkëtimin e tyre. Poashtu të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve si dhe të krijojë strategji të mbledhjes së tyre, përfshirë dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme ligjore për inkasim.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Alban Beka, Udhëheqës i ekipit



Xhevat Hasolli, Anëtar i ekipit



Valon Halimi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve	Kontrata Kolektive e Arsimit është nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Arsimit (MASHT) dhe SBASHK-ut, ndërsa Komuna nuk është palë nënshkruese e kësaj kontrate dhe nuk ka nënshkruar ndonjë marrëveshje të veçantë për marrjen e detyrimeve financiare që burojnë nga ajo. Për më tepër, vetë komunat kanë kundërshtuar në vazhdimësi bartjen e këtyre obligimeve financiare tek niveli lokal, duke theksuar se nuk janë nënshkruese të kontratës dhe se obligimet financiare duhet të mbulohen nga niveli qendror.	Ne kemi trajtuar klasifikimin e kategorive ekonomike të prezantuara në pasqyrat financiare të Komunës, nga buxheti i së cilës janë realizuar pagesat. Me këtë rast është konstatuar se shpenzimet nuk ishin klasifikuar në përputhje me planin kontabël. Prandaj, gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.



REPUBLIKA E KOSOVË
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJË MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEÇ

Zyra e Kryetarit të Komunës

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit
Të nderuar,
Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Pejës për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- **Nuk pajtohem** me konstatimin në çështjen B1 lidhur me keq klasifikimin. Kontrata Kolektive e Arsimit është nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Arsimit (MASHT) dhe SBASHK-ut, ndërsa Komuna nuk është palë nënshkruese e kësaj kontrate dhe nuk ka nënshkruar ndonjë marrëveshje të veçantë për marrjen e detyrimeve financiare që burojnë nga ajo. Për më tepër, vetë komunat kanë kundërshtuar në vazhdimësi bartjen e këtyre obligimeve financiare tek niveli lokal, duke theksuar se nuk janë nënshkruese të kontratës dhe se obligimet financiare duhet të mbulohen nga niveli qendror.
- Të çështjet tjera pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Data: 09 Qershor 2026,

Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës Pejë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.